



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Dt. 07.06.2024 Nr.

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 , nenit 80 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Udhëzimit Administrativ nr.05/2022 për procedura konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, Komuna e Fushë Kosovës shpallë :

KONKURS

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i Lirë	Numri i Pëzitivave
1	IP	Nëpunës administrativ dhe mbështetës	Vend i lirë	2

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose ne web. te Komunës),
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te Noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime,
- Dëshmi të përvojës (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit nëpunës administrativ dhe mbështetës :

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, Ligjit Nr.02/L-52, Ligjit Nr.03/L-068 dhe Ligjit Nr.04/L-138, Ligjit për zyrtarët publik nr. 08-L/197, Rregullores nr. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës .

III. Kriteret e kualifikimit për Nëpunës administrativ dhe mbështetës : Përgatitje e mesme shkollore

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Duhet të rrespektojë orarin e punës në përpikmëri,
- Kryen pastrimin e korridoreve, klasave, nyjeve sanitare, kabineteve, zyrave dhe lokaleve tjera të IP, po ashtu kujdeset për ndezjen e kalldasë së IP,
- Bën hedhjen e mbeturinave nga pastrimi i lokaleve të IP në vende të caktuara për këtë,
- Kujdeset për zbatimin e masave sanitare dhe higjienike në lokalet e IP,



- Është përgjegjës për inventar dhe mjete të tjera që i përdor dhe gjenden në lokale ku embajnë pastërtinë, Kontrollon hyrjet dhe daljet në objektet të IP, mban evidencat lidhur me këtë,
- Gjatë orarit të punës së tij i kontrollon të gjitha lokalet e IP dhe i evidenton të gjitha parregullësitë në librin e kujdestarisë,
- Gjatë orarit të punës së tij e kontrollon objektin dhe rrethin e IP dhe kujdeset që të mos ndodh zjarr, vërshime ose plaçkitje,
- Në rast të fatkeqësive të ndryshme, është i obliguar që t'u jap ndihmë femijeve, Kontrollon hyrjen dhe daljen e automjeteve, punëtorëve dhe femijeve.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura. Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë, ndërsa intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë si dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **07.06.2024 deri me 21.06.2024**.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrarët Publikë;

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në Komunë përmes zyrës pritëse në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë-Kosovë.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim
Fatlum Berisha

